

PROCESVERBAL
nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 25.04.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr.Emilija Janevska, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Dragana Veljanovska nga misioni vëzhgues i Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut OSBE(ODIHR).

Z. Petrushevski hapi seancën e 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 20:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 18-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.04.2024.
2. Propozim-udhëzues për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024.
3. Propozim për inicimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP eksport-import - Saraj, Shkup për shkelje të nenit 76-b të Kodit Zgjedhor.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 18-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.04.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Udhëzimin e propozuara për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024. Ai rikujtoi se në seancat e kaluara kishte paralajmëruar se ky Udhëzim do t'i nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve dhe në këtë drejtim shpjegoi se ky është ndryshimi i dytë dhe i fundit i dokumentit, ku rolin kryesor të të cilit e luan reklamimi politik me pagesë (RPP) gjatë zgjedhjeve 2024. Në Udhëzimin e përhershëm, me lexim të kujdesshëm, qartë do të vërehet se nga sa kohë duhet të marrin kandidatët për RPP, por pasi që sot ka pasur një numër të madh thirrjesh nga transmetuesit për atë se sa kohë duhet të ndajnë në rrethin e dytë për Zgjedhjet presidenciale për RPP, dhe në mënyrë që transmetuesit të mos gjënden në situatë që nuk e kanë kuptuar ligjin, në Udhëzim është bërë qartë një ndryshim dhe tregohet se çdo kandidatët pjesëmarrës në rrethin e dytë të Zgjedhjet Presidenciale kanë një kohë maksimale prej 4 minutash në një orë reale. Në pajtim të kësaj shtese dhe pjesëve të tjera të Udhëzimit janë përshtatur për dy kandidatët që hyjnë në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore, si mënyra e raportimit në shërbimin publik dhe përfaqësimi i tyre falas.

Z. Petrushevski tha se ky ndryshim është në fakt versioni përfundimtar i Udhëzuesit dhe deklaroi se do ta mbështesë atë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Udhëzimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë dhe t'ua dorëzojë transmetuesve dhe palëve të tjera të interesuara.

Të përpilohet tekst i pastruar i Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP eksport-import - Saraj, Shkup për shkelje të nenit 76-b të Kodit Zgjedhor. Ai shpjegoi se më 23 prill në TV Klan është transmetuar emision debatues, ndërsa para debatit ka pasur inçizime nga paraqitja e kryetarit të VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski dhe kryetarit të BDI-së, Ali Ahmeti, të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin zgjedhor. Në pajtim me Kodin Zgjedhor, gjatë kohës së heshtjes nuk lejohet transmetimi i deklaratave, publikimi i regjistrimeve të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, bartësve të funksioneve publike, funksioneve në qeveri apo në parti politike. Ai shpjegoi se nga inçizimet e shqyrtuara, shërbimi ka konstatuar se dukshëm ishte synimi për shkeljen e heshtjen zgjedhore, me shumë gjasa duke i dhënë përparësi një opsioni të caktuar politik. Siç kujton

ai, një akt i tillë gjatë kohës së heshtjes zgjedhore nuk ka ndodhur, ndoshta që nga organizimi i zgjedhjeve të para demokratike në Republikën e Maqedonisë.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer (monitorim) mbi prezantimin mediatik zgjedhor nr.10-2054/1 të datës 25.04.2024 të SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP eksport-import - Saraj, Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 76-b paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër SHTR "KLAN MAQEDONI" SHPKNJP EKSPORT-IMPORT - SARAJ, SHKUP që të ngrihet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja është konstatuar se në kundërshtim me nenin 76-b paragrafi (3) dhe në lidhje me nenin 69-a paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor, më datë 23 dhe 24 prill 2024, gjatë informimit në kohën e heshtjes zgjedhore për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024, në disa nga programet/përmbajtjet ka transmetuar informacion dhe materiale audiovizuele që lidhen me ose përfshijnë pjesëmarrës në zgjedhje.

Spektori për çështje juridike duhet të përgatisë Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**